

ZBATIMI I METODOLOGJISË SË TUNING-ut NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE

Nga Julia González, Katherine Isaacs dhe Robert Wagenaar¹

Hyrje

Çfarë është doktoratura në një shoqëri të dijes? Çfarë duhet të jetë ajo? Këto janë pyetje me të cilat po ballafaqohen universitetet dhe shoqëritë e ndryshme në ditët e sotme. Ato janë në kërkim të një përgjigje të re e më të mirë. Cikli i tretë, apo cikli i doktoraturës, është faza kurorëzuese e arsimit të lartë. Universiteteve njihen në opinion për cilësinë e hulumtimeve të bëra prej “doktorëve” të tyre. Ato rregullisht i përmendin të famshmit e tyre - po të jetë e mundur ata që e kanë fituar Çmimin Nobel, që janë produkt i programeve të tyre të doktoraturës. Imazhi i universitetit është i lidhur ngushtë me atë se sa tërheqëse i kanë studimet e doktoraturës në nivel kombëtar, evropian dhe global. Niveli i shkëlqyeshëm i universitetit nganjëherë matet sipas sasisë, cilësisë dhe imazhit të secilit ‘produkt’ të doktoraturës së atij universiteti.

A është i qëlluar ky lloj i matjes? A mjafton? Konteksti i arsimit të lartë po ndryshon me shpejtësi anë e mbanë botës, e veçanërisht në Evropë, dhe në vendet, të cilat e kanë marrë për bazë procesin e Bolonjës. Cikli i tretë po bëhet pjesë – pjesa përfundimtare, e një sistemi të ri të strukturuar arsimor, i cili po jetësohet në shumë vende. A ka ndikim në studimet e doktoraturës ky kontekst në zhvillim e sipër? A mund të jetë pozitiv ndikimi i tij? Cilat janë përgjegjësitë e universiteteve në këtë proces?

Nga këndvështrimi evropian dihet se ballafaqohemi me disa sfida të veçanta. Disa prej tyre janë formuluar në objektivat e Lisbonës, të cilat përqendrohen në arritjen e një roli më konkurrues të kontinentit tonë. Dihet se Evropa ka një trashëgimi të madhe të kulturës, të dijes dhe të mundësisë për hulumtime, të cilat nuk po i zhvillon në kapacitetin e tyre të plotë. Komisioni Evropian një numër të studimeve ka përmendur se Evropa prodhon shumë më pak përqindje të doktorantëve (PhD) se disa vende të tjera, si ShBA-të dhe Japonia. Edhe më keq se kaq, shumica e këtyre përfundojnë në papunësi ose të punësuar në ndonjë vend pune që nuk ka lidhje me ekspertizën e tyre. Për më tepër, duket se për të përfunduar studimet e doktoraturës në Evropë duhet më shumë kohë sesa në ShBA dhe Japoni.²

Sipas ‘Lisbonës’, duhet të ndërtohet një aleancë dhe lidhje e re midis arsimit, hulumtimeve dhe inovacionit. Cikli i tretë është njëri prej mjeteve më dëshmuese për universitetet që të hyjnë në këtë proces në mënyrë të

¹ Autorët i janë mirënjohës Komisionit të Menaxhimit të Tuning-ut, në veçanti Luigi F. Donà dalle Rose dhe Arlene Gilpin, për leximin e hollësishëm që i bënë këtij shkrimi që rezultoi në shumë sugjerime të dobishme për përmirësimin e tekstit origjinal. E falënderojmë po ashtu Guðmundur Hálfðanarson për komentet e tij.

² Komunikatë nga Komisioni – mobilising the brainpower of Europe: enabling universities to make their full contribution to the Lisbon Strategy (2005); Commission Communication on the role of universities in the knowledge society. Shih ueb-faqen e Komisionit Evropian: http://ec.europa.eu/education/index_en.html

drejtpërdrejtë dhe kuptimplotë. Në të vërtetë, universitetet janë në përpjekje për ta përkufizuar sërish rolin e tyre në këtë kontekst. Ato po reagojnë kundrejt kërcënimeve reale dhe atyre që parashihen të vijnë. Ato po themelojnë shkolla për studime pasdiplomike, për hulumtime ose për doktoraturë. Ato po kërkojnë forma të reja të bashkëpunimit me industrinë, dhe po kërkojnë mënyra të reja për financimin e programeve të hulumtimit. Universitetet janë të shqetësuara për shkak të mundësisë së zhvendosjes së financimit për hulumtime prej sistemit akademik diku tjetër. Ato po themelojnë parqe hulumtimesh; ato po hulumtojnë mundësitë për ofrim të përbashkët të doktoraturave dhe të ndërtimit të rrjetave të doktoraturës.

Në asociacionet dhe organizatat e tyre (të tilla si konferencat e rektorëve, Asociacioni i Universiteteve Evropiane, e rrjete të tjera), universitetet e kanë identifikuar nevojën e gjetjes së qasjeve të reja, duke i identifikuar pengesat dhe duke dhënë shembuj të praktikave të mira. Deri më tani, vëmendja e akademikëve ka qenë e përqendruar kryesisht në çështje të rëndësisë së lartë, si struktura, financimi, mundësia për karrierë, punësimi, karakteristika të projekteve të doktoraturës, modele të mbikëqyrjes dhe mundësia për rrjete ndër-universitare.³

Megjithatë, në analizat e fundit thelbi i problemit del se si të përgatiten hulumtuesit e rinj për rolin e tyre të ardhshëm. Cilat kompetenca duhet t'i ketë një doktorant me qëllim që të mund ta merr përsipër një pozitë të përgjegjshme në një shoqëri të dijes? Nga ky këndvështrim kjo pyetje nënkupton një perspektive të re, e cila sfidon disa prej supozimeve themelore të programeve ekzistuese, por edhe ofron një mjet të fuqishëm për riformulimin e tyre. Po që se e pranojmë se cikli i tretë, ashtu si edhe dy ciklet e tjera, duhet të ketë në qendër mësimin, atëherë çfarë pasojash ka kjo për përpilimin dhe jetësimin e programeve të doktoraturës? E para, që programet duhet të organizohen në atë mënyrë që t'i referohen asaj se çfarë do të dijë, kuptojë dhe të jetë në gjendje të bëjë vijuesi në fund të procesit. Po ashtu do të thotë se investimi i kohës së vijuesit do të shqyrtohet me kujdes dhe shfrytëzohet si duhet. Do të thotë se aftësitë që nxënësi do t'i ketë në fund të procesit duhet të jenë në përputhje me tregun e punës si dhe të ofrojnë kënaqësi personale dhe qytetare.

Lexuesi do ta ketë vërejtur se deri më tani iu kemi shmangur përmendjes së shprehjes 'student' kur po i referoheshim 'vijuesve' të ciklit të tretë. Autorët e këtij shkrimi janë në dijeni të plotë të debatit për statusin e 'studentëve' doktorantë. Në njëërën anë, 'studentët' doktorantë janë pjesëmarrës aktiv në procesin e mësimin, madje mund të ndjekin orë mësimi, e në anën tjetër, ata duhet të bëjnë hulumtime origjinale si hulumtues të rinj, edhe pse kjo zakonisht ndodh nën mbikëqyrjen e një apo më shumë se një anëtarit të lartë të personelit akademik. Statusi i tyre mund të pasqyrohet në fjalën 'student'.

³ Seminari i EUA-së për Bolonjën: "Doctoral Programmes for the European Knowledge Society". Salzburg, 3-5 shkurt 2005. General Rapporteur's Report Professor Kirsti Koch Kristensen, Rektor i Universitetit të Bergen-it.; Seminari i Bolonjës për programet e doktoraturës "Matching Ambition with Responsibilities and Resources" (Nice, 7-9 dhjetor 2006) Final Conclusions – Preparing Recommendations for the London Communiqué. Shih ueb-faqen e Asociacionit të Universiteteve Evropiane (EUA): <http://www.eua.be/index.php?id=97> si dhe një artikull të doracakt të EUA-së nga Sandra Bitusikova dhe Lesley Wilson, me titull 'Doctoral Programmes in Europe'. Seksioni: Implementing Bologna in your institution, C4.4-3.

Megjithatë, në disa vende 'studentët' hulumtues janë vet anëtarët e personelit akademik. Prandaj, statusi i studentit të ciklit të tretë ndryshon mjaft prej studentit të ciklit të parë dhe të dytë. Nëse studentët e ciklit të parë, apo studentët në studimet Beçellor, do të quheshin studentë të studimeve themelore ose student junior, dhe studentët e ciklit të dytë apo të studimeve master të quheshin studentë të studimeve diplomike, post-diplomike apo studentë senior, atëherë duket e përshtatshme dhe e dëshirueshme t'u referohemi më ndryshe studentëve të ciklit të tretë. Në këtë artikull e përdorim termin "kandidatë doktorature". Kjo përzgjedhje pasqyron faktin se 'studentët' e ciklit të tretë janë edhe studentë edhe hulumtues të rinj në të njëjtën kohë.

Është e vërtetë se 'hulumtimi' në kuptimin e tij të gjerë është në thelb të shumicës së programeve të doktoraturës, edhe pse sot në ciklin e tretë përfshihen edhe studime profesionale të nivelit të lartë. Megjithatë, roli i kandidatit të doktoraturës nuk përfundon vetëm me mbledhjen dhe analizën e të dhënave, dhe elaborimin e një teksti. Kandidati i suksesshëm i doktoraturës do duhet të jetë në gjendje të zhvillojë njohuri të reja, t'i përhap dhe të demonstrojë se sa dobi kanë për shoqërinë.

Universitetet dhe arsimit i lartë si tërësi duhet t'i pasqyrojnë nevojat e shoqërisë dhe se çfarë kërkohet në të ardhmen nga më të shkolluarit e shoqërisë. Me fjalë të tjera çfarë detyrash do t'ju kërkohet t'i kryejnë? Nuk vihet në pikëpyetje dhe pranohet botërisht se shoqëria ka nevojë për njerëz të cilët janë të aftë për të bërë hulumtime të specializuara. Kjo është një gjë për të cilën programet e doktoraturës i përgatitin kandidatët e tyre. Por, a nuk ka potenciale të tjera të pazhvilluara dhe nevoja të cilat janë të panjohura, të cilat janë thelbësore për një shoqëri të mbështetur në dije, dhe për të cilat nuk bëhet ndonjë përgatitje në shkallë të njëjtë apo edhe nuk merren fare parasysh?

Siç njihet botërisht, në kornizën e procesit të Bolonjës Ministrat e Arsimit të vendeve nënshkruese janë pajtuar se studimet e doktoraturës, si ato të orientuar kah hulumtimet edhe ato profesionale, duhet të shihen si hapi i fundit i arsimit të lartë. Në takimin e tyre në Bergen në maj të vitit 2005, ata u pajtuan për një kornizë të përbashkët të Kualifikimeve në Hapësirën e Arsimit të Lartë Evropian⁴ dhe i ftuan të gjitha vendet që t'i formulojnë Kornizat e tyre Kombëtare të Kualifikimit përfshirë edhe ciklin e tretë.

Për ciklin e tretë, niveli i pranuar i treguesve apo veçorive janë përshtatur si vijon:

"Kualifikimet që dëshmojnë përfundimin e ciklit të tretë u jepen studentëve që:

1. kanë treguar të kuptuar sistematik të fushës së studimit dhe zotërim të shkathtësive dhe metodave të hulumtimit lidhur me atë fushë;
2. kanë treguar aftësinë të krijojnë, përpilojnë, jetësojnë dhe përshtatin hulumtimin e tyre me integritet studiuesi;

⁴ Grupi Punues i Bolonjës për Kornizën e Kualifikimeve, *A Framework for Qualifications of the European Higher Education Area. Copenhagen* (Ministry of Science, Technology and Innovation) Shkurt 2005. Raportin po ashtu mund ta gjeni në ueb-faqen e Bergen-Bolonjës: <http://www.bologna-bergen2005.no/>

3. kanë dhënë kontribut nëpërmjet një hulumtimi origjinal, i cili i zgjeron kufijtë e dijes, duke krijuar një vepër thelbësore, një pjesë e së cilës meriton të botohet në botime shkencore të recensuara në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
4. kanë aftësi për analizë kritike, vlerësim dhe sintetizim të ideve të reja e komplekse;
5. mund të komunikojnë me kolegët e tyre, bashkësinë e gjërë të studiuësve, si dhe me shoqërinë në përgjithësi sa i përket fushës së tyre të ekspertizës;
6. mund të pritët prej tyre t'i promovojnë, brenda kontekstit akademik e profesional, zhvillimet e mëtejshme të teknologjisë, shoqërisë ose kulturës në një shoqëri të orientuar në dije.”

Nga sa mund të shihet, ky formulim është i orientuar kah “studenti në qendër” dhe merr parasysh fushat të cilat nuk janë paraparë tradicionalisht në ciklin e tretë të studimeve, siç janë doktoraturat profesionale në Shëndetësi dhe Përkujdesin Social, Dizajn, Shkencat e Bibliotekarisë dhe Informacionit, Farmakologjinë Klinike, etj. Pra, sa përkon kjo me praktikën e tanishme? Sipas përkufizimit aftësimi në doktoraturë do të mbulonte pikat 1, 2 dhe 3: me përfundimin e disertacionit, kandidati i doktoraturës do të tregojë aftësi për të bërë hulumtim origjinal kuptimplotë. Ofruesit e programeve të doktoraturës duhet të sigurojnë që kandidatët e doktoraturës t'i arrijnë potencialet e tyre edhe në fushat e tjera, e që në të shumtën e rasteve kërkon reflektim dhe risi të mëtejshme.

Sido që të jetë, këta treguesë janë tepër të përgjithshëm, ashtu siç janë menduar të jenë. T'i kthesh ata në pika të prekshme referimi të programeve aktuale, sipas pikëpamjes së Tuning-ut, duhet t'i kthehemi nivelit të fushës lëndore të studimit.

Këtu qëndron nevoja e vërtet që të themelohet një program me veçoritë e tij të qëlluara (apo të një profili akademik e profesional). Pikërisht në këtë nivel, mund të evidentohen nevojat shoqërore, të konceptohen dhe të transformohen në programe përkatëse të doktoraturës, gjithnjë përmes konsultimeve me bartësit kryesorë dhe bashkësinë akademike. Pikërisht në këtë nivel, mund të përkufizohen the përpilohen strategji për zhvillimin e kompetencave kryesore (dijës së duhur, të kuptuarit nga pikëpamja e gjerë dhe e ngushtë, shkathtësitë dhe aftësitë përkatëse). Në këtë nivel mund të mbikëqyret koherenca dhe konsistenca e të gjitha elementeve dhe të ngritet në kontekst ndërkombëtar.

Nga këndvështrimi i Tuning-ut, programet e cilësisë, sot në botë, duhet të nisen nga pika referimi të pranuar ndërkombëtarisht. Projekti Tuning, falë një konsorciumi të 150 universiteteve evropiane, ka mundur të krijojë një pikë të tillë referimi për nëntë fusha të studimit. Po ashtu në bashkëpunim me Tuning-un, edhe rrjete të tjera që u përkasin fushave e lëmenjve të caktuara kanë zhvilluar pika dhe treguesë të ngjashëm referimi. Qasja e Tuning-ut është marrë si shembull nga vende dhe rajone të tjera në Amerikën Latine (19 vende, 186 universitete), në Federatën Ruse dhe në Azinë Qendrore; është në përgatitje e sipër në Gjeorgji dhe rajone të tjera.

Qasja e Tuning-ut duket të jetë në harmoni të plotë me Dokumentin e Gjelbër të Komisionit Evropian 'Hapësira Hulumtuese Evropiane: Perspektiva të Reja'⁵, të botuar në prill të vitit 2007. Objektivi i këtij dokumenti është të fillojë "një debat të gjerë të hapur dhe institucional në atë se çfarë duhet të bëhet për ta krijuar një Hapësirë Hulumtuese Evropiane të përbashkët dhe tërheqëse, e cila do t'i plotësonte nevojat dhe shpresat e shkencëtarëve, biznesit dhe qytetarëve". Njëra prej synimeve të tij është që ta hap para botës Hapësirën Hulumtuese Evropiane. Duke i hedhur këtij dokumenti një vështrim më të kujdesshëm na del se konsultimi nuk përqendrohet aq shumë në masat zhvillimore dhe të infrastrukturës për të çuar përpara Hapësirën Hulumtuese Evropiane, madje edhe më pak në përgatitjen aktuale të hulumtuesve të ardhshëm si të punësuar të nivelit të lartë në shoqëri e biznes.

Sipas Tuning-ut, procesi i të mësuarit të studentët doktorantë kërkon një qasje konstruktive sa i përket planifikimit, përpilimit, jetësimit, ofrimit dhe zgjerimit të programeve të studimit, e cila nuk dallon edhe aq prej qasjes e cila u zhvillua për ciklin e parë dhe të dytë të Bolonjës. Thelbi i metodologjisë së Tuning-ut qëndron në pesë elemente: këto janë 1) Kompetencat gjenerike apo 'shkathtësitë e transferueshme'; 2) Kompetencat në një lëmi specifike (që d.m.th, shkathtësi të të kuptuarit të dijes dhe aftësi përkatëse për një fushë studimi); ngarkesa e studentit me studime e shprehur në kohë (përmes krediteve ECTS); 4) Qasjet karshi mësimnxënies, mësimdhënies dhe vlerësimit (në një kontekst të orientuar kah kompetencat); 5) Zhvillimi i mëtejshëm i cilësisë në programet e bazuara në kompetenca. Secili prej këtyre elementeve kërkon vëmendje të veçantë.

Puna sa i përket dy cikleve të para është botuar në formë të librit dhe në internet.⁶ Synimi i këtij kontributi është të hulumtojë kuptimin e përgjithshëm dhe zbatimin e secilit prej këtyre elementeve në ciklit të tretë.

1. Kompetencat gjenerike

Për ta hulumtuar rëndësinë e kompetencave gjenerike, Tuning-u ka përpiluar një listë prej tridhjetë e një kompetencave të këtilla, e cila u bë objekt i konsultimit me punëdhënësit në institucione akademike e me studentë të studimeve postdiplomike⁷. Se sa dhe si duhen të zhvillohen e lëvrohen secila prej këtyre kompetencave varet prej nivelit dhe llojit të studimeve.

Disa prej tyre bien qartë në qendër të aftësimit për doktoraturë. Shembuj për këtë mund të jenë "aftësia për të menduarit abstrakt, analizë dhe sintezë"; "aftësia për të qenë kritik dhe vet-kritik" dhe "aftësia për të bërë hulumtime në nivel të duhur". Po që se i shohim këto në një situatë konkrete, "aftësia për të menduarit abstrakt, analizë dhe sintezë" mund të nënkuptojë të qenit të aftë

⁵ Tekstin e Dokumentit të Gjelbër (Green Paper) mund ta gjeni në ueb-faqen e Direktoratit të Përgjithshëm për Hulumtim: http://ec.europa.eu/research/era/pdf/era_gp_final_en.pdf.

⁶ Julia González and Robert Wagenaar, eds. *Tuning Educational Structures in Europe. Universities' contribution tot the Bologna Process. An introduction*. Bilbao and Groningen, 2007. Ky botim është botuar në frëngjisht, gjermanisht, italisht, polonisht, rusisht, dhe spanjisht. Përkthimet e tjera mund t'i gjeni në ueb-faqen e Tuning-ut: <http://tuning.unideusto.org/tuningeu>.

⁷ 2008 Hulumtimi Tuning Europe për kompetencat gjenerike dhe për ato specifike lëndore. Hulumtimi 2001 Europe përmbante 30 kompetenca. 25 prej këtyre kompetencave në hulumtimin e bërë më 2008 janë të njëjta ose të krahasueshme me ato të vitit 2001.

për të identifikuar probleme; për të identifikuar literaturë përkatëse për një fushë hulumtimi; për të identifikuar mënyra të mbledhjes së të dhënave të duhura; për të përzgjedhur mjete të duhura analitiko-teorike, dhe praktike; për t'i zbatuar ato; për t'i përshkruar rezultatet dhe shpjeguar përfundimet. Sa i përket "aftësive të të qenit kritik dhe ve-kritik", nëse janë apo nuk janë të suksesshme, programet e doktoraturës e kanë një prej synimeve kryesore t'i formojnë këto aftësi. Zhvillimi i tyre, po ashtu, varet prej zhvillimit të aftësisë për të kuptuar në mënyrë kritike, formimin dhe specifikat lëndore të asaj disipline dhe aftësisë për të reflektuar në vet-interpretimet apo edhe në ato të bëra nga të tjerët për të dhënat e supozimet teorike, duke i spikatur anët e fuqishme dhe të dobëta të tyre. "Shkathtësitë hulumtuese", një emërtim tejet i përgjithësuar, në ciklin e tretë të studimeve duhet të shihen në raport të ngushtë me shkathtësitë tashmë të zhvilluara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Në ciklin e tretë, zakonisht do të përdoren teknika analitike të veçanta, përderisa shpresojmë se problemi në hulumtim do të vazhdojë të shihet si i shumë-anshëm dhe i cili i nënshtrohet qasjeve të ndryshme alternative.

Në ciklin e tretë, ndoshta, mund të pritet që të zhvillohet qartë një kompetencë gjenerike me rëndësi, siç është "aftësia për ta zbatuar dijen në situata praktike". Kjo do të ishte e vërtetë për disa programe të doktoraturës të natyrës shkencore, teknologjike apo aplikative, megjithëse edhe ajo mund të vihet në pikëpyetje. Po me siguri që kjo nuk është realitet me fushat e tjera të studimit. Në përgjithësi, konsultimet e Tuning-ut sa i përket kompetencave gjenerike na tregojnë se kompetenca "zbatimi i dijes në situata praktike" lëvrohet më pak se sa do të dëshironim në ciklin e parë dhe të dytë të programeve diplomike.⁸ Pse kjo duhet të jetë më ndryshe për ciklin e tretë të programeve?

Kompetencat e tilla si "aftësia për të nxjerrë ide të reja (krijimi)", "aftësia për punë të pavarur", "aftësia për të komunikuar me gojë dhe përmes shkrimit në gjuhën amtare" dhe "aftësia për t'i identifikuar, paraqitur dhe zgjidhur problemet" zhvillohen në një shkallë më të madhe apo më të vogël në programet ekzistuese. Megjithatë, për t'i zhvilluar ato duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje dhe t'u jepet rëndësi si dhe të kihet një qasje konstruktive kundrejt tyre. Aftësia për "krijim" mund të nënkuptojë shumë gjëra, jo vetëm krijim artistik dhe letrar, por edhe aftësia për të parë dimensionet e reja dhe lidhje të reja midis fushës së njërit dhe të tjetrit, krijimi i strategjive, gjetja e zgjidhjeve, parashikimi i zhvillimeve të ardhshme dhe ndërlikimeve që mund të paraqesin. "Aftësia për të nxjerrë ide të reja" natyrisht se mund të zhvillohet brenda kufijve të fushës apo projektit hulumtues përkatës, në anën tjetër, ajo mund të përfshijë ndërveprimin me disiplinat fqinje apo diskutime të hollësishme e specifike me kolegë ose mentorë. "Aftësia për punë të pavarur" (që përfshinë menaxhimin e kohës, vet-orientimin, disiplinën dhe aftësinë për t'u përqendruar në temë për një periudhë të gjatë kohore) paraqet një

⁸ Rezultatet e hulumtimeve Tuning Europe 2002 dhe 2008. Rezultatet e hulumtimit të Tuning-ut 2008 tregojnë për shembull se kur bëhet krahasimi midis rëndësisë së parashikuar dhe arritjeve të parashikuara të kompetencës së identifikuar ekziston më shumë se një pike ndryshimi në një shkallë deri në 4.; për të diplomuarit: rëndësia është 3.676 kundrejt arritjes 2.536. Ky rezultat është i krahasueshëm për palën tjetër, punëdhënësit. Po ashtu hulumtimet për Harmonizimin e Amerikës Latine (2006), Rusisë (2006) dhe Gjeorgjisë (2008) tregojnë rezultate të krahasueshme.

kompetencë tejet të rëndësishme e cila zhvillohet mjaft qartë në shumicën e disertacioneve të doktoraturave apo projekteve të hulumtimeve, nganjëherë edhe në atë masë, kur kandidatët e doktoraturës lihen vetëm dhe nuk mbikëqyren nga jashtë për komente dhe orientime shtesë. “Shkathtësitë e komunikimit” janë zhvilluar deri më tani në aspektin teorik, derisa kandidatët e doktoraturës duhet të shkruajnë disertacionin e tyre sipas standardeve akademike dhe t’i paraqesin gjetjet e tyre në seminare apo komisione të doktoraturës.

Megjithëkëtë, në shumicën e rasteve, u kushtohet pak vëmendje zhvillimit të shkathtësive të tilla si nevoja për të komunikuar me një publik më të gjerë studiuesish apo edhe me publikun e gjerë, në përgjithësi. Po ashtu, përvoja tregon se shumë prej kandidatëve të doktoraturës nuk janë në gjendje të bëjnë shkrime efektive akademike, duke sugjeruar se metoda ‘fundosu ose noto’ për mësimin e shkathtësive të komunikimit nuk është e mjaftueshme. Shkrimi efektiv akademik kërkon, natyrisht, organizim të saktë të të dhënave dhe manipulimin e tyre, të kuptuar të vërtetë të fushës, si dhe dije gjuhësore e aftësi për të shkruar prozë të qartë e të saktë.

“Zgjidhja e problemeve” mund të kuptohet në shumë nivele nga më e thjeshta e teknike e deri te niveli më i lartë e më i përgjithësuar, apo te niveli i specializuar. Duket sheshit se çdo projekt i disertacionit apo i hulumtimit i paraqitur për doktoraturë duhet të demonstrojë aftësi për të identifikuar dhe zgjidhur probleme të çfarëdo lloji. Megjithëkëtë, “zgjidhja e problemeve” në nivelin më të lartë nënkupton aftësinë për të identifikuar, definuar dhe konceptuar probleme që kanë të bëjnë me shoqërinë, për të bërë pyetje të përshtatshme, për të gjetur shtigje për hulumtim, për të gjetur dhe propozuar zgjidhje efektive.

Kjo na sjell te një numër kompetencash vitale për shoqërinë dhe roli që pritet ta luajnë hulumtuesit e rinj, e që shpesh nuk janë të përshkruara qartë në planprogramet e ofruara në ciklin e tretë. Shumica prej tyre përkrijnë me, apo mund të përfshiheshin qartë në, pikat 5 dhe 6 të kornizës së kualifikimeve për arsimin e lartë të cituar më lartë. Për shembull ne u referohemi ‘kompetencave gjenerike’ si “aftësia për të përpiluar dhe menaxhuar projekte”, “aftësia për të punuar në ekip” dhe “aftësia për t’i motivuar njerëzit dhe për të shkuar drejt qëllimit të përbashkët (udhëheqja)”. Sot, hulumtimi, brenda apo jashtë akademisë, kërkon përpjekje të integruara në shkallë të gjerë.

Kjo nënkupton se hulumtimi është organizuar shpesh në formë të projekteve, të cilat duhet të ekzekutohen brenda një periudhe të caktuar, duke përdorur burime të kufizuara financiare dhe të tjera. Duket sheshit se kompetencat që nevojiten për të marrë pjesë apo për të menaxhuar projekte të tilla duhet të promovohen dhe zhvillohen në secilin program të ciklit të tretë. Natyrisht që secili që shkruan një propozim për disertacion doktorature, praktikisht, përpilon një projekt; kur ai individ e merr titullin e tij apo të saj, ai apo ajo ka treguar aftësi për ta përfunduar projektin. Mirëpo gjatë studimeve të doktoraturës duhet të zgjerohet dhe thellohet kjo kompetencë në mënyrë që të jetë funksionale në situata të ardhshme të punësimit.

Kompetencat e tilla duhet patjetër të përfshijnë edhe aftësinë për të punuar me të tjerët drejt qëllimeve të përbashkëta. Ato mund t’i përfshijmë nën emërtimin “punë ekipore”. Në nivelin e doktoraturës kjo kompetencë duhet të

kuptohet si kompetencë e nivelit të lartë. Jo vetëm që nënkupton kryerjen e një detyre specifike së bashku me të tjerët, siç bëhet shpesh në dy ciklet e mëhershme, por ajo nënkupton edhe që zgjidhja e problemeve përkatëse kërkon kontributin e njerëzve me edukim e përvoja të ndryshme, si intelektuale, gjuhësore, kombëtare e kështu më radhë. Ajo nënkupton edhe fitimin e aftësive për bashkëpunim; për të dëgjuar dhe vlerësuar përvojat, argumentet dhe pikëpamjet e ndryshme, duke stimuluar një dinamikë pozitive në grupe. Në mijëvjeçarin e tretë, mënyra e vetme për t'iu qasur dhe për t'i zgjidhur shumë probleme që na rrethojnë është përmes përpjekjeve të bashkërenduara të shumë njerëzve me role të ndryshme dhe me investim të mjaftueshëm në strukturat e nevojshme. Fakti që një kandidat i doktoraturës mund të bashkëpunojë në një përpjekje të tillë nuk do të thotë patjetër se ai/ajo do ta përvetësojë kompetencën e përpilimit apo menaxhimit të asaj përpjekje. Kompetencat e përpilimit dhe menaxhimit duhet të zhvillohen dhe të kihen parasysh në mënyrë të veçantë.

Shoqëria me të drejtë mendon se njerëzit që e kanë kryer ciklin e tretë të studimeve janë të aftë për të marrë përsipër përgjegjësi të mëdha në kontekstin në të cilin punojnë. Kjo mund të lidhet me kompetencën e "udhëheqjes". Nga këndvështrimi ynë, në këtë nivel, udhëheqja nënkupton pranimin e përgjegjësive, aftësinë për të marrë iniciativa dhe vendime. Po ashtu nënkupton se të tjerët ju kanë pranuar si kompetent.

Një fushë tjetër e kompetencave me interes për shumicën e kandidatëve të doktoraturës është ajo e mësimdhënies, apo të transmetimit të dijes dhe kompetencave me kohë. Në shumicën e vendeve evropiane, ideja se mësimdhënia dhe hulumtimi duhet të lidhen ngushtë me universitetet (në thelb, po që se kryhet nga individ i njëjtë, ai do të jep e merr në të dy drejtimet) është një e vërtetë në vetevete që nuk kërkon provë të mëtejme. Shumica e doktorantëve, në praktikë, punësohen për të dhënë mësim në shkollat e mesme me shpresë që titulli i fituar në ciklin e tretë do t'ju mundësojë së fundmi të japin mësim dhe të bëjnë hulumtime në një ambient akademik. Por edhe ata që do të punësohen në industri apo diku tjetër në sektorin privat do t'ju kërkohet me siguri që të kontribuojnë në një mënyrë pak a shumë të strukturuar në formimin e kolegëve, ndihmësve, bashkëpunëtorëve dhe të tjerëve. Kjo do të thotë se kompetenca e mësimdhënies duhet të zhvillohet. Diçka e mentalitetit të mësimdhënies duhet të jetë pjesë e trashëgimisë intelektuale dhe praktike të formuar në ciklin e tretë të studimeve. Vet fjala 'doktor' nënkupton atë që jep mësim. Mirëpo shpesh lind pyetja se sa zhvillohen kompetencat e mësimdhënies në studimet e doktoraturës?

Të gjitha kompetencat gjenerike të cilat i kemi diskutuar më lartë janë të lidhura dhe të nevojshme për një individ që kërkon të marrë përgjegjësi të mëdha. Duhet të hulumtojmë se si mund t'i zhvillojmë ato sa më mirë në ciklin e tretë të studimeve. Studimet e ciklit të tretë nënkuptojnë investime të mëdha në para, kohë dhe përpjekje të shoqërisë dhe të vet individëve. Pas përfundimit të doktoraturës, individët duhet të jenë më të përgatitur dhe të aftë për të marrë përsipër përgjegjësi që përkojnë me dijen e tyre, dhe të vazhdojnë ta ndërtojnë përvojën e tyre gjatë tërë jetës.

2. Kompetencat specifike lëndore

Thelbi i metodologjisë së Tuning-ut qëndron në nivelin lëndor. Tuning-u është një projekt i gjerë ndërkombëtar i mbështetur në punën dhe gjetjet e 'Grupeve të Fushave Lëndore' (ang: Subject Area Groups). Këto janë grupe punuese në të cilat akademikët e lëmive specifike nga vende të ndryshme bashkëpunojnë për të zhvilluar pika referimi, lista të kompetencave, elemente përshkrimi dhe terminologji të pajtueshme në fushat e tyre. Ashtu si për dy ciklet e mëparshme, e njëjta ka ndodh edhe për studimet e doktoraturës. Pra grupet punuese të Tuning-ut në nivel lëndor kanë dhënë kontributin e tyre në këtë drejtim, kontribute të cilat formojnë pjesën më të madhe të këtij shkrimi.

Kompetencat për një lëmi të caktuar janë ato që duhet të zhvillohen nga studentët/kandidatët e një fushë të caktuar disiplinare apo tematike. Pra është fusha e studimit, kur flasim në një kontekst bashkëpunues ndërkombëtar, ajo që mund t'i përcaktojë rezultatet kyçe të mësimin në çfarëdo niveli titujsh akademik.

Në diskutimin e më hershëm folëm për kompetencat gjenerike. Ne as nuk propozojmë dhe as nuk besojmë, për shembull, se do të jetë e dobishme të organizohet një lëndë (kurs) i caktuar, të themi në 'udhëheqje'. Përndryshe, në çdo cikël të tretë, organizuesit e programit të doktoraturës do të planifikonin veprimtari të përshtatshme me fushën përkatëse të studimit për t'i zhvilluar kompetencat që i diskutuam më lartë, sipas nevojës edhe për "udhëheqje". Këto duhet të zhvillohen gjatë kryerjes së hulumtimit të kërkuar apo punës në praktikë. E njëjta gjë vlen edhe për të gjitha kompetencat kryesore gjenerike.

Përveç kësaj, programet e doktoraturës duhet të përpilohen natyrshëm për të siguruar zhvillimin e të gjitha kompetencave në një lëmi të caktuar në nivel të lartë. Këto nuk janë vetëm kompetenca instrumentale apo teknike që nevojiten për të bërë një projekt të caktuar hulumtimi. Ato përfshijnë, po ashtu, njohuri për teknika të caktuara të fushës që mund të jenë të dobishme edhe në projekte të ardhme. Për më tepër, ato duhet të përfshijnë njohuri të fushës së studimit: kandidati i doktoraturës duhet të ketë një pasqyrë të plotë e të qartë të bazës epistemologjike të fushës së tij apo saj, ajo që mund të përshkruhet duke i përdorur fjalët përshkuese të kornizës së kualifikimeve për ciklin e tretë, që do të thotë se kandidati duhet "të ketë treguar të kuptuar sistematik të fushës së studimit dhe zotërim të shkathtësive dhe metodave të hulumtimit lidhur me atë fushë".

Nganjëherë gjejmë se studimet e doktoraturës janë formuluar sipas një ideje të nivelit apo progresit në të cilin kandidatët i zhvillojnë njohuritë e tyre duke u mbështetur në njohuritë tejet të përgjithshme e elementare të fituara në shkollë apo në dy ciklet e para, derisa vijnë të zhvillojnë njohuri të hollësishme për një fushë tejet të specializuar në ciklin e tretë. Dyshojmë se një lloj programi i tillë do t'i plotësojë nevojat e tyre. Në radhë të parë, në punësimin e ardhshëm, kandidatit të doktoraturës shpesh do t'i kërkohet që të ketë një pasqyrë për zhvillimet teorike dhe teknike në fushë studimin e tij. Sot, për të dhënë mësim, për të komunikuar, për të planifikuar, për të menaxhuar projekte, 'doktorantët' duhet të kenë nivel të lartë të njohurive në fushën e tyre si dhe atyre përreth.

Është thelbësore për ata që marrin një titull në ciklin e tretë të kenë një varg njohurish sa i përket fushave të përgjithshme të cilën mund ta zgjedh ndonjëri për të bërë hulumtime. Vetëm kështu, në fjalët e kornizës së kualifikimeve për arsimin e lartë, ata do të mund “të komunikojnë me kolegët e tyre, bashkësinë e gjerë të studiuesve, si dhe me shoqërinë”; ose do të mund t’i promovojnë, brenda kontekstit akademik e profesional, zhvillimet e mëtutjeshme të teknologjisë, shoqërisë ose kulturës në një shoqëri të orientuar në dije”. Shqetësimet e tilla nuk lidhen me ‘komunikimin’ në kuptimin e tyre të thjeshtë të marrëdhënieve me publikun, por më tepër me arritjen e njohurive të reja dhe të kuptuarit të hulumtimeve të bëra. Njohuritë e gjera dhe të një niveli të lartë do të jenë thelbësore për “analizë kritike, vlerësim dhe sintezë të ideve të reja”.

Kohëve të fundit janë rritur shqetësimet se disa programe të doktoraturës, në fund, prodhojnë dije aq të thellë të një fushe tejet të kufizuar, që mund të përshkruhet si të njohësh gati gjithçka pothuaj për asgjë. Në këtë kontekst, ata që kanë tituj të doktoraturës nuk gjejnë punë lehtë (përveç në fushat e tyre të kufizuara të studimit), dhe mund të mos e kenë aftësinë për t’i zhvilluar kompetencat e tyre, përfshirë edhe njohuritë, në fushat e tjera me dobi. Po ashtu, edhe aspektet imagjinative dhe krijuese të hulumtimit, që nënkuptojnë kompetenca të tilla si ‘grykimi’ (për të dhënë gjykime të arsyeshme për gjërat që mund të kemi vetëm informacione të pjesëshme), do të lëngojnë po që se themeli i dijes nuk është krijuar si duhet.

Me fjalë të tjera, Tuning-u sugjeron se nuk janë të mjaftueshme njohuritë elementare të një fushe të gjerë që përvetësohen në dy ciklet e para. Duhet të ekzistojë vetëdija që ‘doktori’ duhet të ketë nevojë për njohuri më të thella, apo të një niveli më të lartë – sipas metaforës së përdorur – për fushën e tij dhe fushave përreth.

Në rast se këto programe kanë karakter auto-didaktik, që në të shumtën e rasteve është ashtu, atëherë ajo që pritet nga organizuesit e programeve është që t’i bëjnë këto parakushte të qarta, ta stimulojnë kërkuesin e kandidatit dhe të ofrojnë mundësi për zgjerimin e diapazonit dhe interesit të tyre.

3. Përdorimi i krediteve ECTS në ciklin e tretë

Për përdorimin e krediteve ECTS në ciklin e tretë janë bërë një varg debatesh. Ekziston një lloj pajtimi se kreditet duhet të përdoren për pjesën e programeve për të cilat mbahet mësim. Ekziston më shumë pasiguri sa i përket përdorimit të tyre për t’i planifikuar dhe rregulluar aktivitetet lidhur me disertacionin e doktoraturës ose me projektin e hulumtimit. Megjithatë, mendojmë se në një varg vendesh zbatohen kreditet ECTS në ciklin e tretë.

E mbajmë qëndrimin se, si në dy ciklet e para, kreditet ECTS mund të ofrojnë një mjet të dobishëm të planifikimit dhe menaxhimit për ciklin e tretë nëse kuptohen drejt. ECTS-ja ka në thelb studentin në qendër, dhe është një mjet për ta matur kohën që, në kushte absolute, do t’i nevojitet studentit/kandidatit për t’i arritur rezultatet e mësimnxënies. Vështruar nga ky aspekt, kreditet janë vetëm një mjet i thjeshtë e i përdorshëm për ta matur realizimin e asaj që u kërkojmë të bëjnë studentëve ose kandidatëve të doktoraturës.

Një ankesë e rëndomtë, pothuaj se përfundim universal, është që kandidatët e doktoraturës sot kanë nevojë për më shumë kohë se sa është e specifikuar ligjërisht për t'i përfunduar studimet. Programet të cilat ligjërisht dhe në bazë të konceptit duhet të jenë tri ose maksimumi katër vjeçare, zakonisht, zgjasin më shumë deri në përfundim. Dhe se kandidatët e ciklit të tretë shpesh i lënë këto studime, të mbingarkuar nga vështirësitë e përfundimit të projekteve të tyre pa pasur ndonjë strukturë të organizuar.

Ndoshta, për shkak të pasigurisë për dobinë e krediteve ECTS në ciklin e tretë është krijuar mendimi se ato janë të lidhura me rregulla të ashpra të matjes sa i përket ngarkesës në module të vogla në ciklet e mëhershme. Po ashtu, mistika e lidhur me disertacionin e doktoraturës si fryt i sakrificës dhe mundit me vite të tëra e shton këtë pasiguri. Megjithatë, sakrifica dhe mudi me vite të tëra mund të zhduken nëse bëhet një planifikim si duhet, duke u mbështetur në respektin për kandidatët, personelin, kohën dhe përpjekjet e të dy palëve.

Nëse e marrim secilin prej krediteve që tregon angazhimin me studime të studentit apo kandidatit prej 25-30 orësh, atëherë me plotë arsye mund ta përdorim treguesin e përgjithshëm që nënkupton se është e mundur të bëhen programe doktrature tri-vjeçare me barasvlerë kohore prej 180 krediteve ECTS, dhe programe doktrature katër-vjeçare, me barasvlerë kohore prej 240 kreditesh ECTS. Ministrat në Bergen kishin rekomanduar që cikli i tretë të mos bëhej shumë i ngurtë. Sigurisht që kjo është një masë e nevojshme, por në të njëjtën kohë, nxënësi ka të drejtë që të regjistrohet në një program në të cilin ai ose ajo mund t'i kryej aktivitetet e nevojshme gjatë një periudhe të caktuar. Nëse kjo nuk është e mundur për një kandidat normal, të pranuar në program, do të thotë se përpilimi është i gabueshëm.

Në anën tjetër, kreditet zakonisht përdoren për një numër të vogël modulesh në një sistem të mbledhjes së tyre. Lirisht mund të thuhet se programet e doktoraturës kanë vetëm një numër të vogël të moduleve të tilla, e madje mund edhe fare të mos i ken. Fitimi i krediteve ECTS realizohet vetëm kur të bëhet vlerësimi, e ndërsa në disertacionet e doktoraturave klasike, vlerësimi vjen krejtësisht në fund të mbrojtjes publike të atij disertacioni.

Si mund të jenë të dobishme kreditet ECTS?

Siç e kemi përmendur më lartë, ato mund të përdoren në mënyrën e zakonshme për t'ju dhënë kredite secilit komponent që mësohet në programin e doktoraturës, si: kurse, punime laboratorike, seminare, tryeza të punës, ushtrime gjatë një kursi, e të ngjashme. Në disa fusha të studimit, vet disertacioni, apo projekti i hulumtimit, mund të jetë i ndarë në njësi, si në rastin e mjekësisë, ku përbehet prej një numri të punimeve të botuara në revista të recensuara. Në këtë rast, për shembull, do të ishte e arsyeshme dhe e drejtë të jepen një numër kreditesh që përkrijnë me kohën e nevojshme për ta shkruar një artikull të tillë, meqë vlerësimi realisht ndodh në një kontekst të përgjithshëm të bashkësisë së studuesve, dhe jo vetëm sipas dijes dhe gjykimit të mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë.

Në fusha të tjera të studimit vet disertacioni mund të kërkojë një proces të gjatë dhe të ndërlikuar të mbledhjes së të dhënave, analizës dhe zhvillimit të tyre në një monografi të zgjeruar. Në raste të tilla, kreditet për disertacion do

të jepen vetëm kur të mbarojë mbrojtja e tij, dhe si rrjedhojë kur të jepet titulli (edhe pse kandidatët e doktoraturës po kërkojnë që t'u lejohet botimi i kapitujve të disertacioneve të tyre si artikuj në revista apo punime të tjera të përbashkëta para mbrojtjes përfundimtare).

Por edhe në këtë rast, kreditet si matës të kohës mund të përdoren për të siguruar se kërkesat e bëra për kandidatin janë të arsyeshme; se masa e hulumtimit dhe analizës të cilën janë kërkuar ta bëjnë është ligjërisht në proporcion me kohëzgjatjen e studimeve, si dhe për t'i ndihmuar në organizimin e fazave për zhvillimin e projektit të tyre të doktoraturës.

Është fiktive të mendohet se sa më e gjatë që të jetë koha e studimit aq më e madhe do të jetë cilësia apo aq më i madh do të jetë numri i kompetencave të përvetësuar. Për hulumtuesit sot, kompetencat për organizimin e kohës dhe punës së tyre në mënyrë racionale sipas afateve kohore janë zakonisht më të rëndësishme se eksplorimi i pafund i temës së hulumtimit. Vet kandidatët e doktoraturës sillen midis kënaqësisë së lirisë dhe elementeve negative të mungesës së udhëzimeve. Mos obligimi për bërjen e aktiviteteve të caktuara sipas një plani të pajtuar kohor sigurisht që ka shkaktuar braktisjen e studimeve nga shumë kandidatë – një humbje e kohës dhe e përpjekjeve të individit.

Me qëllim të ndreqjes së një situate të tillë, mund të caktohen faza të caktuara apo shenja të progresit gjatë programit tre ose katër vjeçar të doktoraturës. Kreditet, edhe pse nuk jepen derisa pjesa e nxënies të jetë vlerësuar krejtësisht, prapë se prapë mund të jenë një mjet efektiv në planifikimin se sa duhet të kërkohej nga një kandidatë dhe kur.

Për të dhënë një shembull konkret, mund ta imagjinojmë një kandidat të historisë në një program trevjeçar të doktoraturës. Programi trevjeçar në vetvete është një 'projekt', i cili duhet të jetë më i organizuar në fillim dhe t'i jepet më shumë mëvetësi kah fundi, por gjithnjë duke iu përmbajtur afateve të dakorduara kohore. Kandidati do ta ketë përgatitur një prezantim të projektit të tij të hulumtimit me qëllim që të pranohet në studimet e doktoraturës. Duke përdor kreditet si matës kohor, atëherë mund të supozojmë një program si vijon:

Faza	Kreditet apo barasvlera në kohë	Komponentët e mësimimit të mbajtur apo atyre që kreditohen (40 kredite)	Projekti individual i hulumtimit apo disertacioni (140 kredite)	Shenjat e progresit
Semestri i parë	30	5 kredite (125 deri 150 orë) për një seminar teknik (p.sh. paleografi) 5 kredite (125 deri 150 orë)	Barasvlera e 20 krediteve (500 deri 600 orë) prej të cilave gjysma i përkushtohet prodhimit të një bibliografie dhe	Në fund të semestrit: Bibliografia dhe diagrami paraqiten, diskutohen dhe miratohen prej

		për tryezë pune metodologjike të nivelit të lartë	burimeve të botuara të plota dhe bashkëkohore; dhe gjysma tjetër për krijimin e një diagrami të materialeve të dobishme arkivore	një komisioni mbikëqyrës.
Semestri i dytë	30	5 kredite (125 deri 150 orë) për ndjekjen dhe përgatitjen e një seminari të doktoraturës për një grup apo shkollë	Barasvlera prej 25 krediteve (500 deri 600 orë) që i përkushtohen mbledhjes së materialeve dhe burimeve të duhura për lexim; përgatitja e skicës së punimit	Në fund të semestrit: Analiza e punimeve arkivore kryhet dhe miratohet skica e punimit të disertacionit prej komisionit.
Semestri i tretë	30	5 kredite për pjesëmarrje në një seminar të metodologjisë	Barasvlera prej 25 krediteve (500 deri 600 orë) që i përkushtohen mbledhjes së vazhdueshme të të dhënave, analizës dhe organizimit të rezultateve	Në fund të semestrit: Paraqitet pasqyra analitike e përmbajtjes dhe miratohet nga komisioni.
Semestri i katërtë	30	5 kredite për përgatitjen për botim të një artikulli të shkurtër apo të një kritike të një libri	Barasvlera prej 25 krediteve (500 deri 600 orë) që i përkushtohen mbledhjes së vazhdueshme të të dhënave, shkrimit të një kapitulli në formën e tij përfundimtare	Në fund të semestrit: Kapitulli i përfunduar paraqitet dhe miratohet nga komisioni.
Semestri i pestë	30	5 kredite për ndihmën e dhënë në	Barasvlera prej 25 krediteve (500 deri 600	Në fund të semestrit: Përfundohet

		organizimin e një seminari të metodologjisë	orë) që i kushtohen shkrimit dhe kontrolleve të mëtejme sipas nevojës	pjesa më e madhe e kapitujve dhe i paraqiten komisionit në formën e tyre para-përfundimtare
Semestri i gjashtë	30	Për pjesët 'jo-mësimore', e tërë koha t'i përkushtohet lëvrimin përfundimtar të tekstit	Barasvlera prej 30 krediteve (750 deri 900 orë) për punën në disertacion dhe kontrollimin e tij	Kah mesi i semestrit kryhet shkrimi i tekstit të tërë në formën e tij para-përfundimtare; kontrolli arkivor, përmirësimet e prozës dhe punimi i gatshëm për mbrojtje.
		40 kredite të grumbulluara	140 kredite për disertacion jepen kur vlerësimi të përfundojë	Përfundon mbrojtja, titulli jepet (180 kredite të doktoraturës).

Shenjat e progresit mund të zbatohen për secilin program të ciklit të tretë. Natyrisht që hollësitë e tyre varen prej fushës së studimit, prej përkufizimit të rezultateve të synuara dhe strategjive të zgjedhura për t'i arritur ato.

4. Qasjet karshi mësimnxënies, mësimdhënies dhe vlerësimit

Që prej mesjetës strategjia kryesore në mësimdhënie dhe mësimnxënie në edukimin universitar ka qene teza e magjistraturës dhe pastaj disertacioni i doktoraturës, të përgatitura apo të shkruara nën drejtimin e një mentori. Vlerësimi bëhej përmes një diskutimi publik, shpesh i bërë sipas rritualeve të parapara të prezantimit, diskutimit dhe mbrojtjes. Në pyetësorin të cilin e kemi bërë për programet e doktoraturës, është për t'u habitur të shohësh sot në Evropë se sa kujdes tejet të hollësishëm i kushtojnë profesorët kësaj pjese të procesit, e cila zakonisht nuk ndikon në përmbajtjen apo cilësinë e disertacionit, por vetëm e zvarrit procesin. Kohët e fundit kufizimi i disertacionit si një strategji e vetme me dobi për të gjitha rastet dhe për të gjitha fushat e studimit është pranuar dhe ka çuar në formimin e programeve të strukturuar më mirë, që përfshijnë veprimtari të ndryshme, dhe një krijim të gjerë të instituteve të hulumtimit dhe shkollave të doktoraturës.

Për t'i formuar kompetencat e shqyrtuara në pikën 1 dhe 2 më lartë kjo mënyrë duket të jetë e rekomandueshme, e në praktikë e nevojshme. Madje edhe mentori më mendjemprehtë dhe më i kujdesshëm nuk do të ishte në gjendje ta stimulonte zhvillimin e të gjitha kompetencave të nevojshme në nivelin e duhur. Dihet se kompetencat shoqërore dhe bashkëpunuese duhet të formohen me të tjerat, përmes aktiviteteve të ndryshme të mësimi. Kjo është e vërtetë edhe për shumë kompetenca të bazuara në dije, të cilat zhvillohen në ekipe akademike dhe rrjete ndërkombëtare.

Sipas metodologjisë së Tuning-ut, rezultatet e synuara të mësimi në një program definojnë sipas kompetencave kryesore dhe qasjeve më të përshtatshme të mësimnxënies, mësimdhënies dhe vlerësimit që identifikohen e jetësohen. Në rastin e studimeve të doktoraturës mund të përdoret edhe kjo metodë e përgjithshme. Kandidatët dhe profesorët në shumicën e rasteve pajtohen se studimet e doktoraturës duhet të kenë strukturë të elementeve të mësimnxënies, në të cilën mund të fitohen njohuri të nivelit të lart metodologjik e teorik.

Në shumë fusha të studimit është e zakonshme të mbahen 'seminare të doktoraturës' në të cilat ftohen mysafirë eminent të fushës për t'i paraqitur idetë e tyre, e veçanërisht sa i përket temave të reja e të debatueshme. Në raste të tjera, vet kandidatët e doktoraturës, pasi të kenë filluar t'i shohin rezultatet, i paraqesin dhe i diskutojnë ato me kolegët dhe mentorët e tyre. Është e mundur që në një ambient të tillë të zhvillohet një numër i kompetencave, dhe, në kushte ideale, të vihen kandidatët në kontakt me hulumtimet më të avancuara të kohëve të fundit, jo vetëm në qytetin apo institucionin e tyre por më gjerë. Me këtë, nënkuptojmë organizim më të mirë të 'seminarit' në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara: koordinim i prezantimeve të mysafirëve, në atë mënyrë që ata nuk do të mbesin vetëm të ftuar pasi kishin kohë të lirë, por për shkak të kriterëve të përhapjes dhe përparimit të dijes. Edhe pjesa e seminarit e udhëhequr nga 'studenti' mund të zhvillohet në mënyra të ndryshme me qëllim të stimulimit të kompetencave të ndryshme, si: paraqitja e temave të ndërlikuara si duhet si me gojë ashtu edhe me shkrim; kryesimi i takimeve, të dëgjuarit dhe të kuptuarit; diskutimi i ndërtuar mirë dhe me qëllim të dhënies së rezultateve; raportimi; organizimi; puna në ekipe, e të tjera. Në të gjitha këto raste, profesorët dhe kandidatët duhet ta kenë një lloj të qartë se këto kompetenca janë të rëndësishme, dhe duhet të formohen dhe vlerësohen sipas kriterëve të qarta.

'Seminaret' e tilla në një formë a tjetër mund të jenë mjet i fuqishëm për formimin e studiuesve dhe mësimdhënësve që kanë frymë dhe potencial krijues në fushën e tyre. Për fat të keq, nga përvoja mësojmë se aktivitetet e tilla shpesh organizohen me një mënyrë jo të rregullt, që i bëjnë kandidatët të ankohen se vetëm kanë humbur kohë dhe janë detyruar të 'largojnë' prej hulumtimit të tyre.

Format e tjera të veprimtarisë së 'mësimi' apo aktiviteteve të strukturuar që zbatohen në studimet e doktoraturës janë, për shembull, tryezat në një teknikë specifike të specializuar, që mund të mos jenë përvetësuar në ciklet e mëhershme, ose seminare ndërdisiplinare (kërkesë e kandidatëve).

Në të gjitha këto raste, përdorimi i rezultateve të mbështetura në kompetenca të mësimnxënies dhe krediteve për ta përlllogaritur kohën e nevojshme që

duhet t'u kushtohet studimeve do të ndihmonte në sigurimin që aktivitetet e planifikuara të jenë efektive dhe pozitive, dhe jo një barrë e pavlerë. Mësimnxënia me anë të bashkëpunimit në seminare apo në një kontekst laboratorik duket të jetë një mënyrë e mirë për të formuar kompetencat e tilla në nivel doktorature.

Një temë më e debatuar është nëse duhet të ketë më shumë aktivitete në programet e ciklit të tretë, synimi i të cilave është të japin njohuri sistematike të nivelit të lartë që kandidati mund të mos i ketë përvetësuar, në fakt, në atë nivel në ciklet e mëparshme. Ekzistojnë kundërshtime në Evropë për përfshirjen e kurseve të mësimin në nivelin e doktoraturës. Ndërsa, sigurisht që forma klasike e ligjërimit nuk duket të paraqesë një ambient pozitiv për mësim aktiv për hulumtuesit në formim që janë po ashtu nën presion të mjaftueshëm për ta përfunduar punimin e tyre. Megjithatë, për shumë arsye të ndryshme – përfshirë faktin që studentët mund të hyjnë në studimet e doktoraturës me nivel të ndryshëm të dijes; dhe se në çfarëdo rasti shkalla e kompleksitetit me të cilën janë ballafaquar gjatë dy cikleve të mëparshme nuk do të jetë e barabartë me atë që kërkohet në nivelin e tretë – baza e tyre e njohurive duhet të zhvillohet edhe në ciklin e tretë. Siç e kemi cekur më lart, nën pikën 1, ky lloj i njohurive të gjera të nivelit të lartë të secilit në një fushë të caktuar është i nevojshëm për rolin udhëheqës dhe përgjegjësive që doktorantët duhet të jenë në gjendje ta marrin përsipër në çfarëdo situatë të punësimit të ardhshëm.

Secila fushë e studimit e ka përvojën e vet kur kemi të bëjmë me këtë nevojë, dhe për këtë mund të shkëmbehen ide e zgjidhje nga universitetet e ndryshme e sisteme kombëtare. Është pikërisht në nivelin e fushës së studimeve që qasjet specifike mund të zhvillohen dhe vlerësohen. Në të gjitha fushat e studimit, megjithatë, duket e arsyeshme të theksohen strategjitë aktive të mësimin, duke kombinuar zhvillimin e njohurive sistematike të nivelit të lartë me kompetencat e tjera. Tradicionalisht, kandidatët e doktoraturës duhej të lexonin gjerësisht rreth disiplinës të cilën po e hulumtonin. Sot, me qëllim që ta shfrytëzojnë kohën e tyre me efikasitet sugjerohet të përpilohen 'seminare të doktoraturës' në mënyrë sistematike, që kërkon lexime sipas një orari dhe diskutime të punimeve të botuara në kohët e fundit si dhe të kontributeve të hulumtimeve të bëra që mund të kenë ndikim në të ardhmen e disiplinës.

Një qasje tjetër e zakonshme në studimet e ciklit të tretë është të programohen takime të herë pas herë me kandidatit dhe mentorëve apo komisionit mbikëqyrës. Këto takime kryesisht kanë synim të kontrollimit se si po ecën puna e hulumtimit dhe zhvillimit të tekstit përfundimtar apo të punimeve të tjera që shpiejnë në përpilimin e tezës përfundimtare apo disertacionit. Siç e kemi përmendur më lart në pikën 3, duket e dobishme të qartësohet një strukturë e përgjithshme e afateve ndër-kohore apo të shenjave të progresit, të cilat duhet të jenë të qarta si për kandidatin edhe mësimdhënësin/mbikëqyrësin, me qëllim që ta shoqërojnë kandidatin në një kontekst të një mëvetësie në ngritje, deri në marrjen e titullit. Kjo mbase është një praktikë në veprim në shumë vende, ndërsa nuk zbatohet edhe aq shumë në disa vende të tjera.

Përvoja tregon se rekomandohet të kihen së paku dy mbikëqyrës për një kandidatë doktorature, pa marrë parasysh nëse kandidati duhet ta diskutojë

punimin e tij herë pas here edhe me komisionin apo bordin e doktoraturës, me qëllim që të sigurohet informacioni i duhur në një varg çështjesh, pikëpamjesh e ekspertizash të ndryshme.

Natyrisht se vet disertacioni ose projekti i hulumtimit është një shembull *par excellence* i një strategjie të fuqishme e aktive të mësimit. Atë mund ta shohim si shembull, të perfeksionuar gjatë shekujve, të mësimit të orientuar në detyrë. Kandidati i doktoraturës mëson për të bërë hulumtim origjinal duke e praktikuar atë. Në shumë fusha të studimit pranohet se është e dobishme të identifikohen fazat dhe shenjat e progresit, siç i kemi sugjeruar nën pikën 3, me qëllim që të sigurohet që kandidati nuk e ka humbur orientimin prej fushëveprimit të pakufi të hulumtimit dhe të zbulimeve të reja. Meqë synimi i disertacionit është të nxitë shkathtësi hulumtuese të nivelit të lartë dhe të kompetencave përkatëse po të një niveli të lartë, si aftësitë kritike dhe vet-kritike, aftësitë për analizë e sintetizim dhe të ngjashme (por edhe për aftësitë organizative si përpilimi dhe menaxhimi i projektit, dhe përgjegjësia në organizimin e kohës që të mund të përmbushen detyrimet), atëherë duhet të vendoset se sa kohë është e nevojshme për t'i arritur ato rezultate të mësimit, dhe të krijohet fleksibilitet i arsyeshëm për punën e kandidatit. Kjo është edhe më e rëndësishme nga pikëpamja e trendit të kufizimit të kohëzgjatjes së studimeve dhe numrit në rritje të studentëve me korrespondencë, faktorë që ushtrojnë më shumë presion në zhvillimin e shkathtësive të menaxhimit të kohës, organizimit dhe planifikimit.

Treguesë të tjerë të përgjithshëm që gjejnë zbatim në të gjitha fushat e studimit janë si vijon: dimensiononi dhe përkufizimi i strukturës ku procesi i mësimit që organizohet ka nevojë për një shqyrtim të kujdesshëm. Disa prej 'Shkollave të doktoraturës' janë pak më shumë se sa kuti administrative në të cilat një numër i ndryshëm i fushave të studimit janë vënë së bashku, pa marrë parasysh nëse kjo paraqet ndonjë dobi orientuese apo didaktike. Sipas rastit (organizimi i universitetit, numri i kandidatëve, kompetencat specifike në një lëmi, metodat e mësimdhënies e mësimnxënies), mund të jetë që niveli i fakulteteve apo departamenteve të jetë njëri prej niveleve më të qëlluara për organizimin e programeve të doktoraturës. Në anën tjetër, mund të jetë mjaft e dobishme për të organizuar programe që i ofrojnë së bashku departamentet ose fakultetet e institucioneve të ndryshme, të qyteteve e madje edhe të rrjeteve ndërkombëtare. Niveli i vetëdijes dhe ndërveprimit që duhet të zhvillohet në studimet e ciklit të tretë e bënë më të rëndësishme nevojën për të shikuar jasht një institucioni të vetëm.

Në fund, duhet të theksohet se synimi i programeve duhet t'iu shpjegohet qartë kandidatëve. Në të njëjtën mënyrë, duhet të shkoqiten qartë kompetencat që duhet të formohen, si duhet të bëhet kjo dhe se si do të vlerësohen kandidatët. Sot zakonisht ekzistojnë *arcana imperii*: personeli shpesh nuk shqetësohet të shkëmbejë sekretet se pse aktivitetet e caktuara janë planifikuar dhe kandidati shpesh i sheh ato si humbje të kohës meqë mund ta kishin përdorur atë kohë për aktivitete më të mira po që se do të kishin qenë në dijeni të qëllimeve të vëna dhe arsyeve për to. Transparenca është e dobishme jo vetëm për kandidatët e doktoraturës por edhe për organizuesit e programeve të ciklit të tretë, duke treguar qartë si kompetencat, ambientin e mësimit, dhe se metodat e vlerësimit dhe kriteret përkrijnë mirë me njëra-tjetrën.


5. Zbatimi i mjeteve të cilësisë së Tuning-ut në përpilimin dhe zhvillimin e programeve të doktoraturës

Ende sot studimet e doktoraturës organizohen sipas traditave kombëtare, shumica e të cilave janë efektive në lloje të caktuara të përgatitjeve të gjeneratave dhe hulumtuesve të rinj, dhe se funksioni i disa të tjerave as që nuk vihet në pikëpyetje sa i përket nevojave të tashme.

Me fjalë të tjera, në masë të madhe personeli akademi ende po përpiqet ta riprodhojnë veten duke prodhuar hulumtues universitarë, derisa trendi duhet të jetë drejt krijimit të programeve të doktoraturave në të cilat zhvillohen kompetenca të nivelit prej kandidatëve doktorantë në mënyrë që të përgatiten sa më mirë për rolet e reja në shoqëri, e jo vetëm për ato të hulumtuesve tradicionalë.

Kjo do të thotë se koncepti i programit të doktoraturës duhet ta zëvendësojë idenë se secili kandidat e ka 'programin' e vet. Për të krijuar programe të tilla kërkohet një qasje e mirë dhe e strukturuar.

Tuning-u ka zhvilluar një procedurë dhe mjete praktike për vlerësimin dhe përpilimin apo ripërpilimin e programeve cilësore. Të formuluar në fillim për dy ciklet e para, ato janë po aq të përshtatshme edhe për ciklin e tretë. "Cikli i cilësisë së Tuning-ut" është një cikël i cili sjell informacione pozitive, që përfshin përpilimin, jetësimin, monitorimin dhe vlerësimin si dhe të harmonizimin e mirëfilltë të përpilimit të programeve dhe jetësimit të tyre.



Me qëllim të përpilimit me efikasitet të programeve të ciklit të tretë mund të ndiqen këta hapa, të përshtaten dhe të zbatohen në situata specifike dhe të shfrytëzohen rekomandimet për fushat e studimit të bëra nga Tuning-u.

1. A ekziston nevoja?

Hapi i parë është të dihet nëse ka nevojë për një program të caktuar të doktoraturës, dhe nëse po, të përcaktohen karakteristikat që duhet t'i ketë. Kjo duhet të bëhet në këshillim me akademikët, punonjësit, vet kandidatët, dhe të tjerët. Është thelbësore të dihet se cila është gjendja e doktorantëve tanë: a janë të punësuar? Ku? Për çfarë kompetenca kanë nevojë?

Në vendet ku ka pak ndihma financiare për kandidatët e doktoraturës do të jetë, në fakt, e vështirë të përgatitet një numër i mjaftueshëm i mësuesve dhe hulumtuesve ekspertë për t'i plotësuar vendet në departamentet e universiteteve me rastin e daljes në pension të personelit aktual. Më shumë e zakonisht është situata kur universitetet për një arsye ose tjetër inkurajohen (apo e shohin si të dobishme) që të pranojnë një numër shumë më të madh të kandidatëve se sa do të mund të pranoheshin në akademi, dhe më i madh se sa mundësitë absorbuese të qendrave dhe organizmave përkatëse hulumtuese. Administratorët dhe personeli universitar duhet të vlerësojë me kujdes se cilat do të jenë në të vërtetë mundësitë e doktorantëve të diplomuar, para se ata të krijojnë programe të reja, apo para se të vendosin t'i ripërpilojnë programet ekzistuese.

2. Përcakto profilin dhe kompetencat kryesore

Hapi i dytë është përcaktimi i profilit akademik dhe profesional të doktorantëve të ardhshëm. Në cilën fushë të dijes do të orientohet ekspertiza e tij apo e saj? Programi do të ketë një emër. Në shumicën e rasteve ato ende kanë një emër gjenerik, që vjen prej traditës mesjetare – një *Philosophiae doctor* aktualisht do të kultivojë një degë të dijes, e cila në pak raste ka të bëjë me atë çfarë e quajmë sot Filozofi. Pa marrë parasysh emërtimin e titullit, i cili do të jepet, programi zakonisht duhet të planifikohet në nivel të fushës së studimit, apo së paku në një nivel të një nënndarje të fushës së studimit (p.sh. fizikë, astrofizikë, akustikë).

Në shumicën e rasteve, kur vendoset për fushën dhe shkallën e caktuar të programit dhe nevojës për ta themeluar, atëherë duhet të përdoren dhe të përshkruhen si veçoritë akademike të programit ashtu edhe lloji i profesioneve që do të jepen, pra duke krijuar një profil akademik dhe profesional, i cili ofron një element të përgjithshëm të qartësisë dhe transparencës si për kandidatët ashtu edhe për personelin.

Në fakt, në bazë të profilit, do të jetë e mundur të identifikohen dhe përkufizohen kompetencat kryesore, të cilat kandidati duhet t'i ketë në fund të ciklit të tretë. Këto kompetenca do të jenë si gjenerike ashtu edhe specifike për një lëmi, sipas modelit që e kemi cekur më lartë, duke marrë parasysh kontekstin kombëtarë dhe ndërkombëtarë (dhe si rrjedhojë i kemi rezultatet e Tuning-ut për fushat e studimit të përshkruara më poshtë, dhe të botuara në ueb-faqen e Tuning-ut). Një çështje me rëndësi është se mbikëqyrësit me përvojë kanë shpesh ide të forta, por që nuk e artikulojnë se çfarë kompetencash duhet të zhvillohen dhe nuk i bëhen gjithnjë të qarta kandidatit që në fillim të programit. Doktorantët e rinj profesional mund të ofrojnë

frymëzim dhe shembull të praktikave të mira se si mund të identifikohen këto kompetenca⁹.

3. Përcakto rezultatet e nxënies që vënë në pah kompetencat më të rëndësishme

Duke marrë parasysh kompetencat kryesore të identifikuara në hapin e mëparshëm përcakto rezultatet e nxënies në saje të asaj se çfarë duhet të dijë doktoranti, të kuptojë, dhe të jetë në gjendje të bëjë në fund të programit. Kjo nënkupton që të sqarohen mirë dhe qartë rezultatet e synuara që zakonisht supozohen të jenë të ditura për të gjithë, por që shpesh mbesin, në fakt, të paqarta, posaçërisht për kandidatët e doktoraturës, të cilët kanë arsye të shëndosha për të kuptuar qartë se çfarë pritet prej tyre dhe se çfarë pritet që ata të arrijnë.

4. Vendos për elementet strukturore të programit

Për ciklin e parë dhe të dytë ky hap kërkon të vendoset se si të ndahen kreditet në dispozicion në njësi të lëndës apo kursit. Për ciklin e tretë, çështja parësore që duhet të vendoset zakonisht është se sa kohë prej kohës së kandidatit duhet t'i përkushtohet projektit të doktoraturës dhe sa pjesës së programit për 'mësim' (aty ku kjo ofrohet), dhe planifikimit të tyre në mënyrë që të stimulohet formimi i të gjitha kompetencave kryesore të identifikuara në hapat e mëparshëm.

5. Përcakto rezultatet e nxënies dhe të kompetencave kryesore që duhet të arrihen

Për secilin modul 'të mësim' dhe për secilën 'shenjë të progresit' gjatë zhvillimit të disertacionit apo të projektit të hulumtimit përcakto se çfarë duhet të ketë arritur kandidati, dhe se cilat kompetenca do të formohen në këtë mënyrë dhe në ç'niveli.

6. Shih se në ç'mënyrë mund të formohen dhe vlerësohen më së miri këto kompetenca, duke përdorë formate të ndryshme (strategji të mësimit/mësimdhënies/vlerësimit)

Vendos për secilin aktivitet se si mund të organizohet më së miri. Për shembull, a do të jenë 'shkathtësitë e komunikimit' një objektivë e veçantë në 'seminaret e doktoraturës'? A do të jetë ajo e mjaftueshme? Apo duhet që kandidati të inkurajohet dhe t'i kërkohet që ta paraqes punën e tij ose të saj në një konferencë shkencore? Dhe a do të jetë 'menaxhimi i projekteve' një kompetencë që do të matet vetëm përmes projektit të vet kandidatit? Apo duhet t'i jepen kandidatit përgjegjësi të qarta për organizimin e një apo më shumë fazave të një projekti më të madh e që përfshinë më shumë njerëz? Si do të vlerësohen këto kompetenca dhe të tjera?

7. Sigurohu nëse janë marrë parasysh të gjitha kompetencat gjenerike dhe për lëmi specifike

Me të kryer hapin e gjashtë duhet të bëhet një kontroll i përgjithshëm i kompetencave të nevojshme dhe të dëshirueshme për t'u siguruar se

⁹ Shembuj të doktoraturave të reja profesionale mund të gjenden lehtë në Internet duke kërkuar me 'new professional doctorates'.

kandidati me rastin e përfundimit të aktiviteteve të planifikuara do t'i përvetësojë të gjitha kompetencat e nevojshme dhe se do të vlerësohet në bazë të tyre dhe në mënyrë të qartë.

8. Përshkruaj njësitë programore dhe të lëndëve, duke i paraqitur rezultatet e nxënies në saje të kompetencave

Përshkruaj qartë aktivitetet e ndryshme të cilat do të kërkohen të kryhen prej kandidatit, duke i shpjeguar aktivitetet në saje të rezultateve të dëshiruara (kompetencat që duhet t'i përvetësoj dhe t'i zgjeroj kandidati). Po ashtu duhet të përshkruhen edhe metodat që do të përdoren (përshkrimi i ambientit mësimor dhe metodave e kriterëve të vlerësimit); demonstro që e tëra është shpërndarë si duhet në kohën në dispozicion dhe në mënyrë të arsyeshme, duke i lënë kandidatit kohë të mjaftueshme për ta bërë hulumtimin e tij në mënyrë të pavarur, por edhe duke i definuar shenjat e progresit për të kontrolluar nëse po ecin gjërat drejt, si dhe për t'u siguruar nëse janë zhvilluar shkathtësitë e nevojshme hulumtuese.

9. Kontrolllo baraspeshën midis aktiviteteve dhe periudhës kohore

Sigurohu që të gjitha aktivitetet e shënuara janë në harmoni me njëra-tjetrën; shih këtë në aspektin e përgjithshëm kështu që do të ketë periudha kur ka më shumë aktivitete të strukturuar, dhe të tjera kur kandidati ka më shumë liri. Për shembull, lejo hapësirë për kandidatin të shkojë jashtë vendit, për shembull, për të hulumtuar në biblioteka dhe arkiva të huaja, dhe për të ndjekur konferenca në fushën e tij të specializimit.

10. Jetëso, monitoro dhe vlerëso rezultatet, ndrysho sipas nevojës

Thelbi i tërë kësaj është që t'i jepet kandidatit një përvojë sa më e mirë dhe më e qartë e studimit. Monitorimi dhe vlerësimi i programit dhe i rezultateve të tij, natyrisht, se do të jenë thelbësore, dhe se kandidatët duhet të luajnë rol në procesin e vlerësimit. E tëra duhet të përshtatet sipas përvojës me qëllim që të 'harmonizohet' programi i doktoraturës.

Përfundime

Në fund, le t'i hedhim një sy asaj që e kemi thënë deri më tash nga tri këndvështrimet tona: prej atij të universiteteve, të shoqërisë, dhe prej këndvështrimit më të rëndësishëm, atij të kandidatit të doktoraturës.

Prej këndvështrimit të universiteteve, ekzistojnë presione për t'i tërhequr sa më shumë kandidatët e doktoraturës. Programet e doktoraturës nënkuptojnë prestigj, e në veçanti kur mund të jepen një numër i arsyeshëm i titujve të doktoraturës. Po ashtu, programet e doktoraturës janë pjesë e thelbit të biznesit të universiteteve. Në të njëjtën kohë, universitetet mbajnë përgjegjësi sa i përket karrierës së ardhshme të kandidatëve. Universitetet nuk mund të mbështeten thjeshtë në kornizën aktuale apo 'të vetëkënaqen me arritjet e tyre'. Kurora e këtyre arritjeve është simbol i kryerjes së ciklit të tretë, por shumë syresh duhet ta fshehin atë. Doktoratura duhet të jetë biletë për të hyrë në një punë të përshtatshme për nivelin e edukimit të ciklit të tretë. Mirëpo kështu nuk ndodh gjithnjë. Në një varg fushash akademike dhe në vende të ndryshme doktorantët e kanë të vështirë të gjejnë punë sepse punëdhënësit

mendojnë se janë të papërshtatshëm për postet në dispozicion, dhe në një farë mase mund të kërkojnë më shumë sa i përket pagesave. Me fjalë të tjera, mendohet shpesh se doktorantët nuk mund të kontribuojnë, në të vërtetë, në procesin e punës, sepse u mungon qëndrimi i duhur dhe nuk i kanë kompetencat e nevojshme. Nëse këto opinione e pasqyrojnë realitetin apo pasqyrojnë vetëm një paragjykim mbetet një pyetje e hapur.

Meqë u tha kjo, universitet e kanë për detyrë të themelojnë programe bashkëkohore të doktoraturës dhe t'i menaxhojnë ato me përgjegjësi. Nuk mjafton vetëm t'u lejosh kandidatëve të regjistrohen dhe të kontaktojnë me një mentor, dhe, eventualisht, në rastet më të mira, ta paraqesin disertacionin. Në këtë mënyrë, humbet shumë kohë dhe mund njeriu; dhe në fund, edhe pse sado origjinale dhe i zgjeruar të jetë disertacioni ai nuk do të njihet aq shumë dhe se kandidati nuk do të ketë dobi prej tij në jetën personale dhe profesionale.

Kjo nënkupton se programet e doktoraturës duhet të përpilohen, jetësohen dhe të mbahen në atë mënyrë që t'i kontribuojnë jo vetëm agjendës së institucionit, por edhe t'i kenë parasysh nevojat e shoqërisë dhe t'i shpiejnë drejt punësimit të përshtatshëm ata që e fitojnë titullin e doktorit. Kjo nënkupton, mes tjerash, se programet e doktoraturës duhet t'i zhvillojnë kompetencat gjenerike si dhe ato kompetenca për lëndë specifike në një nivel të lartë.

Në të njëjtën kohë, shoqëria ka nevojë për doktorantë të diplomuar, persona me një aftësim të lartë në fusha të dijes që janë komplekse dhe të specializuara, e që sot janë thelbësore për funksionimin e shoqërisë. Jo vetëm që ata duhet të jenë në gjendje të krijojnë, zhvillojnë, ruajnë dhe transmetojnë dije, një detyrë e madhe në vetvete, por ata duhet t'i kenë edhe shkathtësitë e nevojshme hulumtuese për ta zgjeruar dhe lëvruar edhe më tej dijen, duke i marrë përgjegjësitë e nevojshme kundrejt shoqërisë, dhe për të qenë në gjendje të organizojnë dhe marrin pjesë në projekte të mëdha, të cilat kërkojnë përpjekje dhe inteligjencë të bashkërenduara të shumë njerëzve me kompetenca nga më të ndryshmet.

Programet e organizuara qartë dhe racionalisht, duke u përqendruar në përvetësimin e një varg kompetencash të përgjithshme e përkatëse do të jenë shumë të dobishme për kandidatin e doktoraturës. Kandidatët do ta kenë entuziazmin për të bërë hulumtime origjinale, për të eksploruar territore të panjohura, duke i përdorur dhe i vënë në provë të gjitha kompetencat, dijen, të kuptuarit dhe shkathtësitë e tyre, pa qenë të detyruar që në fund të kuptojnë se arritjet e tyre nuk pranohen nga shoqëria dhe mbase nuk kanë, në të vërtetë, ndonjë të mirë për të. Në të njëjtën kohë, kandidatët duhet të jenë të vetëdijshëm dhe ta pranojnë që prej fillimit se jo vetëm që do të përgatiten për një punë në akademi, por para së gjithash, për një rol udhëheqës jashtë akademisë apo në organizatat përkatëse që merren me punë kërkimore.

Të gjitha këto janë arsye bindëse për zhvillimin e programeve cilësore të doktoraturës sipas një perspektive të re.

Bilbao, Groningen dhe Pisa, 2008

Aneksi 1:

Shabllon për programet e ciklit të tretë:

Njësia	Sugjerim të elementeve që të kihen parasysh	Të plotësohet sipas nevojave të institucionit të caktuar, duke marrë parasysh kornizën ligjore dhe pikat e referencës së Tuning-ut për fushat lëndore.
1. Hyrje në programin e doktoraturës:	<p>Si përshtatet programi në profilin dhe misionin e vet institucionit? Cilat janë avantazhet dhe fushat me arritje të shkëlqyeshme? Të kihen parasysh se cilat janë grupet kryesore të hulumtimit, temat kryesore të kultivuara, boshllëku, nëse ka rrjete ndërkombëtare, dhënie të përbashkët të titujve, etj.</p> <p>Të kihet parasysh se ku punësohen 'doktorët' e rinj dhe në çfarë kapaciteti.</p>	
2. Profili i titullit dhe i profesionit:	Përkufizimi akademik i titullit: funksionet profesionale të kandidatit, të cilat do të mund t'i kryejnë dhe shkallën e përgjegjësisë që do të mund ta marrin përsipër.	
3. Rezultatet e mësimit dhe kompetencat, përshkruesit e nivelit të ciklit.	<p>Korniza Evropiane e Kualifikimeve në përgjithësi:</p> <ol style="list-style-type: none">1. kanë treguar të kuptuar sistematik të fushës së studimit dhe zotërim të shkathtësive dhe metodave të hulumtimit lidhur me atë fushën;2. kanë treguar aftësi të	Kompetencat gjenerike të Tuning-ut në nivele të duhura plus kompetencat specifike lëndore

	<p>krijojnë, përpilojnë, jetësojnë dhe përshtatin hulumtimin e tyre me integritet studiuesi;</p> <p>3. kanë dhënë kontribut nëpërmjet një hulumtimi origjinal, i cili i zgjeron kufijtë e dijes duke krijuar një vepër thelbësore, një pjesë e së cilës meriton të botohet në botime shkencore të recensuara në nivel kombëtar e ndërkombëtar;</p> <p>4. kanë aftësi për analiza kritike, vlerësime dhe sintetizim të ideve të reja dhe komplekse;</p> <p>5. mund të komunikojnë me kolegët e tyre, bashkësinë e gjerë të studiuesve, si dhe me shoqërinë në përgjithësi sa i përket fushës së tyre të ekspertizës;</p> <p>6. mund të pritët prej tyre të promovojnë, brenda kontekstit akademik e profesional, zhvillimet e mëtejshme të teknologjisë, shoqërisë ose kulturës në një shoqëri të orientuar në dije.</p>	
<p>4. Ngarkesa dhe ECTS</p>	<p>180 deri 240 kredite (25-30 orë të punës së studentit për kredit), prej të cilave një pjesë t'i kushtohet miratimit të disertacionit apo projektit; një pjesë t'u kushtohet moduleve apo aktiviteteve të planifikuara kur ato vlerësohen dhe studenti/kandidati ka treguar se ai/ajo i zotëron kompetencat e</p>	

	nevojshme	
5. Mësimnxënia, mësimdhënia dhe vlerësimi	Përcaktimi i ambientit mësimor dhe i metodave të vlerësimit (p.sh. seminare javore me kandidatët e tjerë të doktoraturës, të organizuara me radhë nga grupe të kandidatëve, të cilët e përgatisin organizimin logjistik, udhëheqin takimin, udhëheqin diskutimin, raportojnë; apo sesione laboratorike në të cilat demonstrohen dhe përsëriten teknika të caktuara; etj.)	
6. Ngritja e cilësisë	Cilat procedura (vet-vlerësim, vlerësim i jashtëm, pjesëmarrje e kandidatit, etj.) ekzistojnë për ta garantuar cilësinë.	